



Trajneri Ukrainas ne konferencen per shtyp perpara mediave ju pergjigj edhe pyetjeve rreth dy futbollisteve shqiptare qe luajne me Cernomorets, Kristi Vangjeli dhe Elis Bakaj nese ata do te aktivizoheshin ne ndeshjen e neserme?.

“Nuk e di pergjigjen e kesaj pyetjeve. Ne akoma nuk e kemi vendosur se cilet lojtare do te luajne. Nuk e bejme listen deri ne gjysmen e pare te dites se ndeshjes”, u shpreh Roman Hryhorchuck i cili beson se aktivizimi i futbollisteve ndaj ish skuadrave te tyre jo gjithmone eshte pozitiv.

“Ka ndodhur qe une kam patur lojtare te cilet i kam aktivizuar ndaj ish skuadrave qe ata kane qene pjestare, por asnjehere ne Europa Ligë apo Liga e Kampioneve. Zakonisht ndodh qe prezantimi i tyre eshte i mire, por ka raste qe ndodh edhe e kunderta, sepse emocionet mund te ndikojne negativisht dhe ta preventojne lojtarin qe te paraqesi maksimumin e tij, por nuk besoj se kjo mund te ndodhi ne rastin e lojtareve qe behet fjale pasi ata jane profesionista”, perfundoi prononcimin e tij trajneri Ukrainas rreth aktivizimit te Bakajt ose Vangjelit ne takimin e dites se enjte